THIRRJE PËR SHPREHJE INTERESI

PËR ORGANIZIMIN E PANAIRIT/KONFERENCËS DHE SHËRBIME AKTIVITETESH

NË KUADËR TË KONFERENCËS SË INVESTIMEVE BE–BALLKANI PERËNDIMOR "HORIZONTE TË REJA"PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE NË KUADËR TË ORGANIZIMIT TË KONFERENCËS SË INVESTIMEVE BE–BALLKANI PERËNDIMOR "HORIZONTE TË REJA"

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) shpall thirrjen për angazhimin e një profesionisti me përvojë ndërkombëtare për ofrimin e shërbimeve në kuadër të organizimit dhe zhvillimit të Konferencës së Investimeve BE–Ballkani Perëndimor "Horizonte të Reja" (New Frontier Investment Conference), e cila do të zhvillohet në datat 25–26 nëntor 2026, me aktivitete pararendëse më 24 nëntor 2026.

Angazhimi do të përfshijë shërbime të planifikimit dhe koordinimit të programit, konceptimit dhe kurimit të paneleve, identifikimit dhe angazhimit të folësve të nivelit të lartë, moderimit të aktiviteteve, si dhe ndjekjes së rezultateve pas përfundimit të konferencës.

Përshkrimi i shërbimit dhe angazhimit

Profesionisti i angazhuar do të jetë përgjegjës për ofrimin e mbështetjes profesionale gjatë tri fazave:

Faza I – Përgatitja dhe koordinimi paraprak

- Konceptimi dhe strukturimi i paneleve dhe diskutimeve.
- Identifikimi, kontaktimi dhe angazhimi i folësve të nivelit të lartë.
- Koordinimi me folësit dhe organizatorët për konfirmimin e pjesëmarrjes.
- Përgatitja e strukturës së diskutimeve dhe pyetjeve orientuese.

Faza II – Zhvillimi dhe moderimi i aktiviteteve

- Përgatitja e skenarit të detajuar të konferencës.
- Prezantimi dhe moderimi i sesioneve dhe paneleve.
- Kontributi në ceremonitë hapëse dhe aktivitetet e programit.
- Koordinimi i rrjedhës së programit dhe menaxhimi i diskutimeve.
- Bashkëpunimi me ekipin organizator dhe folësit gjatë zhvillimit të konferencës.

Faza III – Ndjekja pas konferencës

- Dokumentimi i mesazheve kryesore dhe rekomandimeve të paneleve.
- Ndjekja e komunikimit me folësit dhe panelistët.
- Identifikimi i mundësive për bashkëpunim të mëtejshëm.
- Përgatitja e një raporti përfundimtar mbi rezultatet dhe vijimësinë pas konferencës.

Kriteret që duhet të plotësojë kandidati

Kandidati duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- Të ketë mbi 5 vite përvojë profesionale në organizimin, kurimin dhe moderimin e konferencave, forumeve dhe aktiviteteve ndërkombëtare.
- Të ketë përvojë të dëshmuar në moderimin e aktiviteteve me pjesëmarrjen e personaliteteve të nivelit të lartë, përfaqësuesve institucionalë dhe drejtuesve të biznesit.
- Të ketë njohuri dhe përvojë në fushat e ekonomisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.
- Të dëshmojë aftësi të shkëlqyera komunikimi, prezantimi, koordinimi dhe organizimi.
- Të ketë rrjet ndërkombëtar kontaktesh dhe aftësi për angazhimin e folësve të nivelit të lartë.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

Dokumentacioni që duhet të paraqitet

Dosja e aplikimit duhet të përmbajë:

- Letër interesi.
- Jetëshkrimi / Curriculum Vitae.
- Portofol profesional me përvojën në aktivitete të ngjashme.

- Referenca profesionale dhe/ose materiale audiovizive që dëshmojnë përvojën e mëparshme.
- Propozim konceptual për realizimin e shërbimit, duke përfshirë qasjen për secilën nga tri fazat.
- Ofertë financiare të detajuar, të ndarë sipas fazave të angazhimit.
- Deklaratë mbi konfliktin e mundshëm të interesit.
- Deklaratë mbi integritetin profesional dhe ligjor.

Procedura e përzgjedhjes

Aplikimet e paraqitura do të shqyrtohen nga një komision i përbërë nga 3 (tre) anëtarë.

Gjatë procesit të përzgjedhjes do të merren në konsideratë:

- Përvoja dhe profili profesional e ndërkombëtar i kandidatit;
- Përvoja në kurimin dhe moderimin e konferencave dhe aktiviteteve të nivelit të lartë;
- Rrjeti ndërkombëtar i kontakteve dhe aftësia për angazhimin e folësve;
- Cilësia e propozimit konceptual dhe metodologjia e propozuar;
- Oferta financiare dhe realizueshmëria e saj.

Afati i dorëzimit të aplikimeve: Kjo thirrje do të qëndrojë e hapur deri më 19.11.2026, ora 16:30.

Aplikimi dhe dokumentacioni përkatës duhet të dorëzohen pranë zyrës së protokollit të institucionit, me adresë: **Rruga "Skerdilajd Llagami", Nd. 1, H. 6, Tiranë**, ose në adresën zyrtare të e-mailit: **info@aida.gov.al**.